

85H - 1

A - 83



ASDRENI

Lulēkuqja

15
3

105-113

891:-P83 - 1

A - 83 ASDRENI

(Aleksandër Stavre Drenova)

S 24837

MOLIJERAK SMTIE
GJIROKASTER

11 31

8A
Dra 8

LULEKUQJA


Zgjedhur dhe redaktuar

nga

Dhimitër Fullani

LIBRARI I NATIONALES SRISSHES

N. SH. Botimeve «NAIM FRASHERI»
TIRANE, 1958



A S D R E N I
(Aleksandăr Stavre Drenova)
1872—1947

~~G. RUMIĆ~~ TË DASHUR PIONIERË

A e njihni këtë burrë me mustaqe të zeza, që ju shikon me ëmbëlsi? Sigurisht që ju nuk e keni parë atë, se kur jetoi dhe punoi ai, shumë prej jush ende nuk kishin lerë. Por emërin do t'ia keni dëgjuar patjetër, kur keni lexuar poezitë e tij në shkollë. Ai është Aleksandër Stavre Drenova, i njojur me pseudonimin «Asdren», një nga poetët tanë më të çquar, nxënës i Naimit dhe shok i ngushtë i Çajupit.

Aleksandri lindi në një familje të varfër të Drenovës së Korçës më 11 prill 1872. Prindërit i vdiqën porsa mbaroi shkollën greqishte të fshatit, prandaj u detyrua të mërgojet në Rumani që në moshën 17 vjeçare, ku e kaloi gadi tërë jetën deri sa vdiq më 12 dhjetor 1947.

Asdreni qe i vobekët. Në fillim atje, në mërgim, bënte punë të rënda si qymyrxhi, cirak dyqani, a si sekretar i ndonjë tregtari, ku shpërblehej sa për të nxjerrë bukën e gojës. Me vështirësi të mëdha e kreua shkollën e mesme të natës. Kur u bë poet i njojur dhe atdhetar i çquar, bashkatdhetarët e nderuan shumë dhe e ndihmuant kur e panë keq.

Por varfëria nuk e pengoi aspak Asdrenin që të punojë pa u lodhur si poet i atdheut të tij.

Ju e dini të dashur pionierë se 60 e sa vjet përpara populli ynë u ngrit në luftë kundër zgjedhës 500 vjeçare të Turqisë, për ta bëre Shqipërinë, atdheun tonë të dashur, një vënd të lirë. Nga gjiri i këtij populli duallnë aherë një varg shkrimtarësh si Naimi e Sami Frashëri, Çajupi, Mjeda, Asdreni e tjerë, që me fjalën e tyre të zjarrtë çuan peshë zemrën e shqiptarit për atdhe e i dhanë flakë luftës për liri. Me frymën e atdhe-dashurisë, që ishte përhapur tek shqiptarët e Rumanisë u farkëtua shpirti patriotik i Asdrenit dhe nën shëmbullin e poezisë së Naimit lindi poezia e tij.

Ai është një nga mësuesit e parë të shkollës shqipe. Pesëdhjetë e sa vjet përpara ai ngriti shkollën fillore shqipe në qytetin Kostancë të Rumanisë dhe u mësoi fëmijve të shqiptarëve të mërguar atje shkrimin e gjuhës sonë. Shumicën e vjershave ai i bëri për fëmijët e shkollave tona të para. Por poezitë e tij janë me qindra. Ai botoi 3 vëllime me poezi. I pari me titull «Reza djelli» dolli nga shtypi më 1904, i dyti «Endra e lote», më 1912 dhe i treti «Psallme murgu», më 1930.

Asdreni u bë një nga atdhetarët më të çquar të kohës dhe kënga e tij buçiste bashkë me atë të Çajupit që në fillim të shekullit tonë, për ta ngritur popullin shqiptar në luftën e lirisë së Atdheut :

*Qitni pallën si ju dini
Edhe kordhën në e kini,
Me gjithë zemër e pandjesë,
Bini qenit të pabesë.*

*Lexoni hymnet e marrshet e Asdrenit dhe do
të shikoni sa kryelartë do ta ndjeni vreten, se
jeni bijt e kësaj Shqiprije heroike, bijt e atyre
që luftuan me trimëri të madhe për ta çliruar
Atdheun nga zgjedha e huaj. Që më 1908 ai kri-
joi hymnin tonë kombëtar. Me vargjet e këtij
hymni në gojë dhanë jetën sa e sa dëshmorë për
liranë e Atdheut:*

*Pranë flamurit të bashkuar,
Me një dëshirë, me një qëllim,
Të gjithë atje duk'u betuar
Ta lidhim besën për shpëtim*

*Vjersha e tij ta mbush shpirtin me një da-
shuri të ëmbël, që buron nga një zëmër aq e da-
shur për Atdhenë në mjerim, në robërti:*

*Shqipëri o mëma ime
Lot po derdh prej zëmrës sime,
Se je e tretur si qiri.
Hape gjirin, hapi krahtë,
Të të puth gojën e thatë
Me një mall e dashuri.*

*Asdreni, këndoi me krenari kombëtare për
(gjuhën shqipe, për trimëritë e shqiptarit në luf-
trat e lirisë.)*

*Te vjershat e tij ju do të shikoni se sa dashu-
ri të madhe kishte ai për fshatarët e puntorët e
varfër, që turreshin në ballë të luftës dhe sa fort
i urrente ai feudalët, që e shfrytëzonin popullin
dhe tradhëtonin atdhenë :*

«Këta janë turpi i atdheut
Edhe plaga e Shqipërisë».

Asdreni luftoi për një atdhe të lirë jo vetëm nga të huajët por edhe nga shfrytëzuesit e vendit. Ai deshi një atdhe për vegjelinë, për popullin punonjës, prandaj e dënoi më gjithë shpirt në poezitë e tij regjimin e bejlerve dhe të borgjezive me Zogun në krye, që po i thithnin gjakun popullit e po shkatrronin çdo gjë, për të mbushur xhepat e veta.

Asdreni na ka lënë gjithashtu shumë poezi
të bukura për natyrën dhe punën. Ai i këndoi me
bukuri të madhe natyrës shqiptare, bujkut pu-
nëtor. Sa dashuri kishte ai për punën e puntorin,
aq e urrente përtacin!

«Puna është nder

Për çdo njeri me mend,

Përtimi është vrer

Pa fjalë e pa kuyend».

Ju do të kënaqeni me ato poezi të bukura,
ku Asdreni i këndon stinave, muajve të motit
dhe jetës së fshatarëve sidomos në pranverë:

«Çunat lozin, vashat qepin,

Plakat e urta tjerrin lesh;

Nuset tundin, shkundin djepin,

Burrat shatnë, pleqtë grepin,

një bën fjalë e tjetri qesh.»

Na që jemi më të motshëm se ju i dijmë
edhe sot përmendësh shumë poezi t'Asdrenit,

aq fort na kanë pasë pëlqyer. I këndonim atëhere
në shkollë, ose i recitonim në klasë me aqë zell
përpara mësuesit, sa zemra na rrihte nga gjëzimi si
zemër zogu.

Sot në Shqipërinë e re, kur populli i udhë-
hequr prej partisë sonë të Punës po ndërton So-
cializmin dhe po vihet kështu në jetë dëshira aq
e zjarrtë e Asdrenit për një atdhe të popullit pu-
njonjes, vjersha dhe kënga e tij do të këndohen
edhe më me zell nga shkollarët tanë. Na do t'i Ne
kemi ato si gjëra të shtrejta, se ato janë pjesë e
pandarë e një thesari aq të çmuar, që na lanë tra-
shëgim të parët tanë.

DHIMITËR FULLANI

!!
mëso të shkonash.

Të vjeni shumë, t'ju fëmijëroj,
Por mëllë këtë, t'ju shkoni vesa.

Asgjë mbi dhe s'qëndron pëc gjithëve,

Si trashëgim ju lënë shpallin tonë.

Ne shkojm' o shokë, po s'na shuhet shpresa,

Se fjalën që ju lënë si pasqyrë,

Gjithmonë do ta feta shembell, vel.

146
Herr Gott sei Dank für alle Güte die du mir gegeben hast. Ich kann nicht anders denken als daß du mir die Güte gegeben hast weil du mich zu dir geholt hast. Ich kann nicht anders denken als daß du mir die Güte gegeben hast weil du mich zu dir geholt hast. Ich kann nicht anders denken als daß du mir die Güte gegeben hast weil du mich zu dir geholt hast. Ich kann nicht anders denken als daß du mir die Güte gegeben hast weil du mich zu dir geholt hast. Ich kann nicht anders denken als daß du mir die Güte gegeben hast weil du mich zu dir geholt hast.

DIMITER EUTYNI



per qdri nisci ma nesci,
per qdri nisci ma nesci.
Per qdri a po hanceta.

per qdri nisci ma nesci, per qdri nisci ma nesci.
per qdri nisci ma nesci, per qdri nisci ma nesci.

per qdri nisci ma nesci, per qdri nisci ma nesci.

per qdri nisci ma nesci, per qdri nisci ma nesci.

per qdri nisci ma nesci, per qdri nisci ma nesci.

per qdri nisci ma nesci, per qdri nisci ma nesci.
per qdri nisci ma nesci, per qdri nisci ma nesci.

TË RINJVE

O ju që vini paskëtaj plot shpresë,
 Si ata që s'dinë çase psherëtimi,
 Që s'panë vojtje-e as durim mërgimi,
 As zemrave pik helmi që t'u zbresë !

Na rrugën drejt e mbajtmë gjith me ndjesë,¹⁾
 Të tretur shumë herë nga trishtimi ;
 Por mjaltë krejt na dukej hidhërimi
 Kur shihnim se fjala jonë zinte besë²⁾.

Por na ju lemë, shkojmë si shkon vesa,
 Asgjë mbi dhe s'qëndron për gjithëmonë,
 Si trashëgim ju lemë shpirtin tonë.

Ne shkojm' o shokë, po s'na shuhet shpresa.
 Se fjalën që ju lamë si pasqyrë,
 Gjithmonë do ta keni shëmbelltyrë.

1) ndjesë-a = të ndjerët e fajit, të folurit e fajit. Por këtu auktori e ka përdorë me kuptimin: me ndjenjë. (Na shkuam drejt rrugës së luftës për liri, duke qenë të frymëzuar me ndjenjën e atdhedashurisë).

2) zinte besë = Fitonte besim në popull, besohej.

Këndoni djema e ardhmja ësht e juaj
 Risia ¹⁾ është një lule, bukuri;
 Gëzoniju tashi në moshën tuaj
 Si edhe prendvera rreth kur derth magji.

Dhe gruri fushës korret, bëhet duaj
 Çdo lule çel ndë kohë, s'ka se si ²⁾).
 E pak' ështëjeta, moti sa një muaj;
 Dëfreni e valle dredhni ³⁾ përsëri!

Shkon koha e bukur, vjeshta vjen afrohet,
 Ze bryma zbardh mi fletë e gjelbërime;
 Fytyrës s'dheut si faqe-e ngjyr' i ndrohet

Dhe ju të rinj, me këngë dhe gëzime,
 Ngadal' bryma mi kryet kur t'u shtrohet,
 Ather si pleq... dëfreni me kujtime!

VLESA E ATDHEUT

Sa të dua o Shqipëri,
 Sa mall ndjenj e sa dëshirë,
 Për ty gaz e dashuri
 Mu në zemrë më ka mbirë.
 Se përmua ti o atdhe
 Je një lule aq' e vyer,
 Sa nuk gjendet përmi dhe,

1) risia = rinia, të rritë.

2) s'ka se si = s'ka se si të ngjajë ndryshe.

3) dredhni (valle) = hidhni valle.

Shpirtin tem për ta ushqyer.
Qindra vjete gjith në zi
Qindra vjetësh i helmuar,
Po një vlerë pate ti,
Që s'ka shëmbëll s'ësht dëgjuar.
Vala shkuan përmi ty,
Kombe shkelnë pa mëshirë,
Po një s'pati faq' e sy,
Të të shoh' prej dheut fshirë.
Se ke trima si më s'ka
Se ke burra të pavdirë¹⁾ ,
Droja syrin s'ua ha²⁾ ,
Sisën t'ënde kanë pirë.
Mos ki frikë, mos vajto,
Mos me kryet, trupin zgjatur,³⁾
Tunde krahun u forco,
Dëfto namin⁴⁾ që ke patur!


1912

1) të pavdire = që nuk mund të humbin e të treten. Këtu me kuptimin: *të pamundëshëm*.

2) Droja syrin ua ha = frika syrin nuk ua kap; nuk u trembet syri.

3) Mos me kryet = mos me kryet ulur, mos e mbaj kryet poshtë, por mbaje trupin drejt (zgjatur).

4) namin = famën.



BETIMI MI FLAMUR

(Hymn patriotik)

Reth flamurit të përbashkuar
Me një dëshir' e një qëllim,
Të gjith atij duk' iu betuar,
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte vec ay largohet,
Që është lindur tradhëtor.
Kush është burrë nuk frikohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor !

Në dorë armët do t'i mbajmë,
Të mbrojm' atdhenë më çdo kënd,
Të drejtat tonë s'i ndajmë,

Këtu armiqtë s'kanë vend.
Se zoti vetë e tha me gojë,
Që kombe shuhën përmbi dhe,
Po Shqipëria do të rojë;
Për 'te, për 'te luftojmë ne!

PËRPARA !

(Marsh kombëtar)

Lart Shqipëri,
Ti je e zonja,
Nga lufta sot mos ndalesh;
Me trimëri
Porsi shqiponja
Armiqve mos u falesh!
Si burr' u sul, ata dërmoi.
Me gjak të drejtat mbroi;
Përpara shko, përpara!

FLAMURI KOMBETAR

Ne bijt' e tu,
Për tyn' o memë
Forcojmë krahun tonë;
Që ti kështu,
Në lot e gjemë
Mos jesh pér gjithëmonë.
Luanët, trimat sot po presin
Me nder pér ty të vdesin,
Përpara shko, përpara!

Mos ki kujdes, öspitris tui
Mos trembesh kurrë, östov zot se
Ji trime si qëmoti,
Se sot ti s'vdes,
Kur djal' e burrë
Me armë del i zoti
E drejta sheshit do të dalë,
Na thot' e shenjta fjalë.
Përpara shko, përpara !

1912

2485
11 344
BIBLIOTEKA E SHKOLLËS
GJIROR KASTER



FLAMURI KOMBËTAR

Ngjyr' e kuqe si e zjarrit
Dhe shqiponja me dy krerë,
I qendisur me fill t'arit,
Gjer' e gjatë bukur prerë.

Qindra vjete kanë shkuar,
Dit' të zeza e plot me zi,
Po ty fama s' t'është shuar,
M'gjith q'u-trete, u-bëre hi.

Ti je yll'i mirësisë
Edhe engjell'i shpëtimit,
Se ti i dhe djelmërisë
Lulen bukur të kujtimit.

Ndënë ty pra djelmuria,
Me dëshirë e me shpresë,
Do t'luftonjë, që Shqipria
Të rojë e të mos vdesë.

1902

ARDHI DITA

Ardhi koha, ardhi dita,
Iku nata dolli drita,
Ngrihi trima mos përtoni,
Këtë kohë ta shpëtoni !

S'është mjaft sa duruat
Edhe tër' ato që vuat?

Është turp për emrin tuaj,
Të mundohi për të huaj!

Qitni pallën, si ju dini
Edhe kordhën¹⁾ në e kini,

Me gjith zemër e pa ndjesë
Bini qenit të pabesë !

Mjaft me rrobënë të çjerë,
Mbronì vatrën, mbronì nderë !

1) Kordhën = Shpatën.

Ç'mbani duart si të thata?
Nxirni shata edhe shpata,

Ferrat, gjemba i qëroni,
Lule të mbijnë në doni!

Për trima ju trima jini,
Këtë dhe ju vet' e dini!

Po ç'dobi është për atdhenë,
Kur s'ësht ashtu si ka qëni!

Shqipërinë ju në doni,
Nga kët rezik ta shpëtoni.

Kryet ngrini, zgjedhën shtini²⁾,
Pastaj lumtur³⁾ që të jini!

Në jini ju atdhetarë
Dhe të thjeshtë shqipëtarë,

Bënie ju sot atdhenë
Siç që nënë Skënderbenë!

2) Shtini = shtini poshtë, mposhteni.

3) lumtur = të lumtur.

PALLA E SKËNDERBEUT

Trimëria e Skënderbeut,
Që qe dëgjuar n'anët e dheut,
Kish frikësuar turqit téré,
Që s'dinin se ç'qe pér të bërë.
Pér këtë punë Sulltani mendoi
E ca njerëz të zgjedhur dërgoi,
Të cilët, pas urdhërit q'u kish dhënë,
Të venë të shohin Skënderbenë.
T'i shohin edhe pallën të lëvduar,
Me të cilën kaqë lufta kish lëftuar.
Vallë çfarë do t'jetë kjo pallë
Që s'i la asnjë ushëtar të gjallë?
Këta ndë Shqipëri posa vanë
Edhe Skënderbenë si ç'e panë,
— «Nga mbreti, thanë, jemi dërguar,
Që të shohim pallën aqë të lëvduar... »
Rreth e rrrotull mesalles ku rrinin,
Nepër téré anët sytë po i shtinin.
Panë roba, panë armë të arta,
Panë kordha edhe palla të zjarta,
Po pallën të dëgjuar nuk' e njihnin
Edhe në vend nuk' u vinte të rrinin.
Po trimi ngrihet e pallën mer në dorë:
— «Dilni jashtë pakë, thotë, o të gjorë! »
Jasht posa duallë, me çudi panë:
Një kalë që qe lidhur atje pranë,
Skënderbeu afrohet, e me pallën që mban
I bie kalit, e që nënë bark e sipër më dysh
e ndan.
Këta kështu sa panë u hoqnë gjer në mur
E atje mbetnë në vent posa një gur.



Pastaj i qasen Skënderbeut pranë
Që ta pyesin për tër ato që panë.
— «Çfarë qenka, thanë, kjo palla jote
Me aq' trimëri që na rrëfen zotrote,
Kur mbreti yn ka t'artë t'ergjentë,
Të mveshur gjith me gurë të shtrenjtë.
Palla tij që në luftë gjëmon
Edhe qytete të mbëdha që dërmon
E kjo aq' e rëndë e aq' e gjatë
Mund të luftonje me'të dit' e natë?
Po trimi përgjigjet e u - thotë urtë:
«Vin' i thonë mbretit tuaj zemrëgurtë
Se s'pret palla q'është një hekur i dheut,
Po pret dor' e fuqishme e Skënderbeut!'

1901



B A L A S H I T

O balash o bukurosh,
Që je trim si një fatosh¹⁾),
O dragua kali im,
Që po pret me padurim;
Në ke mall për Shqipëri,
Ngjeshu kalë, ji gati.

Shih sa vënd plot bukuri
Ku del ar, ku del flori,
Ku ndrit dielli me shkëlqim

1) Fatosh = fatos.

Dhc qesh hëna me pëlqim;
Si në vënd të prallave,
Trimave dhe pallave!

Ku një pyll, ku një mburim,
Male e fusha pa mbarim,
Me lëndina plot magji,
Ku dredh këngë trimi i ri,
Ku del zana për mëngjes,
Lule thurur gjer në bres.

Shpjermë, shpjermë o balash
Si hark rugën drejt ta mbash;
Çili këmbët mos u-dro
Shkëmbinj, kodra m'i kapto²⁾
Malit lart t'i ngjitemi,
Jemi trima e s'vritemi!

Tin' i shpejtë plot fuqi,
Unë burrë, trim i ri,
Kur armiku ne ~~na~~ del,
Shqipérinë për m'e shkel,
Si luan t'i hidhemi, o dëshid ~~o~~
Prej tij ne mos dridhemi! ~~o~~

Si shqiponja me thonj, **krah'** ~~o~~
Prej zemrimit zjarr që ha; ~~o~~
Si rrufeja sa më shpejt ~~mos~~
Balash derdhu atje drejt,
Ta rëzojmë posht mbërdhe,
Më mos shkelë në atdhe.

2) i kapto = hidhi, kapércei.

Sepse armiku ku u bë hi,
Atje lule ka me mbi,
Dhe, ku këmba na ka shkel,
Trëndafili ka m'u çel;
Pika e djersës ku q'u derth,
Kurrë bari s'ka m'u-mverth.

Faqebardhë që të dy
Do të jemi për çdo sy,
Kur të shohin më çdo mur
Një shqiponjë një flamur
Dhe të thonë pa kujdes³⁾;
Shqipëria kurrë s'vdes !

1911

D H È M K È

Që vjete i larguar
o i dashur atdhe,
Kurrë s'të kam harruar,
se shum' i ëmbël je.

Zemra gjithë më këndon
për ty o Shqipëri,
Po më tepër më lëngon,
sc je në vobësi.⁴⁾

Ah ! sa hidhërimë ndjenj,
o i bukur vënd.
Hir as gjékundi s'gjej,
kur tynë të përmënd.

3) pa kujdes = pa ngurrim, pa dyshuar.

4) vobësi = vobegësi.

Të falura të dërgoj
që këtu o atdhe.
Dhe gjithënë të kujtoj,
se bir ti më ke.

Për ty shumë më vjen keq
o i mjer atdhe,
Pra mëndjen teje s'e heq,
se zemra nuk' më le.

1904

NË MËRGIM

I mërguar prej shtëpisë,
Prej atdheut vendit tim,
Kur agimi i djalërisë
Zu ndriçonte me shkëlqim,
Aty lark i mallëngyer,
Porsi murgu në shkreti,
Po mejtohem zemërthyer :
Vall' a kthehem përsëri ? !

Ti moj shpezë udhëtare,
Që përpjetë fluturon
Me vrapi, që s'lodhesh fare
Nëpër viset ti ku shkon ;

Ecë, ecë shpezë e lirë,
Që më dukesh sikur flet,
Dhe një lajmë sill të mirë :
Një të «falur me shëndet» !



Detëtar, o trim o burrë,
Nëpër valat që këndon,
Dhe nga deti s'druhesh kurrë,
Kur fryn era edh'e trazon !

Ec o djalëth i gjëzuar
Ndë atë anë mb'atë vis,
Sill një lule të bekuar
Nga ay vent si paradhis !

Edhe ti ylli i mëngjezit,
Që sheh ditën kur mburon,
Që ke qenë bres pas brezit
Ylli i bukur që ndriton,

Si kandile e pashuar
Që ndë jetë s'ka shterim,
Dërgoi dritë të uruar
Atij vendit, dheut tim !»

Harrim, o harrim³⁾ i shkretë,
Ti i bën gjithë zemrat gur!
Ti ndan njerinë për jetë
Edh' i rri përpara si mur!
S'e le kurrë të mënjetohet,
Se larg shuhet e shkretohet!

Ti moj Shqipëri e mjërë
Sa durove e sa duron,
Bijtë q'i kishe një herë
Sot për sot më kot i kërkon;
Se të sotmët të harruan
As s'të njojin as s'të duan⁴⁾!

Vuaj sa mund moj e gjorë,
Besë, shpresë fare mos ki
Se sot s'gjendet ajo dorë,⁵⁾
Siç qe, të t'bëjë përsëri.
Se bijtë tu jan' verbuar
Nga çarja,⁶⁾ q'i ka pushtuar!

Ca nga feja dhe padia
Kanë rënë në gjakësi⁷⁾,
Të tjerë nga marrëzia
Lenë prindër edhe shtëpi.
Shkojnë, ikinë, botën zënë,
Kur të zbathur, kur të pangrënë.

3, 4) Harrim, o harrim... = Këtu flet me keqardhje të madhe për ata që janë mërguar dhe harrojnë vëndin dhe njerzit e tyre.

5) Ajo dorë = dora e Skënderbeut, që sa qe gjallë i bashkoi shqiptarët në luftë kundër Turqisë dhe e mbajti shqipërinë të lirë.

6) Çarja = përçarja.

7) Gjakësi = hakmarrja (zakon i keq që kanë patur shqiptarët të vritnin njeritjetrin për të marrë gjak).

As zgjohuni mor të mjerë
Dhe mblidhuni prap' n'atë vënd ! ⁸⁾
Mos për botën, për të tjerë,
Mos punoni kështu pa mënd.
Po vatrën tuaj kujtoni,
Mos e lini mos e shkrettoni !

Turp për një komb të këtillë,
Të mos jet' i zoti për' të,
Kur të tjerë pa këshillë
I mburon, ⁹⁾ pa të shohë gjë,
Dhe veten fare s'e shëkon,
Po më keq e prish, e dërmon !

1904

8) N'atë vend = në Shqipëri.

9) Kur të tjerët pa këshillë i mburon = Kur të tjerët (kombet tjerë) pa këshillë (pa patur nevojë për këshillë, për nxitje) i mburon (i pasuron, bën që t'u mburojë liria, pasuria).



D R I N I T

Drin o lumë, o i madh lumë,
Që sjell vala, gurë shumë,
Që shëkon udhës me buçime
Dhe mbush malet me gjëmime;
Që lak anës fusha, fshatra,
Kur ti rendën më të katra,
Pse je sot ti i egërsuar,
Vetull mvrojtur, zemëruar?
Vall' e ndjen ti robërinë,

Oë e ka mbytur Shqipérinë,
Q'ësht' e shkelur, copëtuar,
Vargonj lidhur këmb' e duar
Nga të huajt q'e dërmuan,
Krejt që e çveshnë, që e ropnë
Dhe e thëthijtnë gjer sa u-ngopnë?
Oë kur Zoti të ka bërë
Drin o lumë i zgjat i gjerë,
Shqipërisë ç'i ka ngjarë,
Ti të gjitha i ke parë!
Se çdo luftë që ka krisur,
Kundr' armiqve q'është nisur,
I pe mundjet plot çkëlqime
Që përmenden si kujtime.
Ata trimat e vërtetë,
Që dëftonin se ndë jetë
Kurrë s'trembet shqipëtari,
Që ka zemër gjak si zjari.
Koh' e keqe apo e mirë,
Mot i bukur apo i nxirë,
Qoftë natë, qoftë ditë
Si në t'errët e në dritë;
I ke parë, i ke dëgjuar,
Kur ty pranë kanë shkuar,
Dhe kăluar dhe më këmbë,
T'armatosur gjer më dhëmbë,
Luanë e trima të pavdirë,
Kryelartër, zemërlirë.
Burrë e grua, plak e djale,
Gjith me zemër, jo me fjalë,
Si fatosa që luftonin,
Shqipérinë të shpëtonin.
Dhe të lirë dhe të mirë,

Plot me gas e plot me hirë,
Në mes tyre rrонin, shkonin,
Dashurinë s'e harronin.

.....
.....

Po sot vallë, sot si janë?
Kryeunjur an' e mb'anë.
Sot më s'eshtë ay zjari,
Që e kishte shqipëtari.
Ay gjaku që valonte,
Kur detyra ia kërkonte,
Me një fjal' e me një besë,
Për atdhen' ay të vdesë;
Pasjen, gjënë mos kursejë,
Trimërinë të rrëfejë.
Sot një heshtje, një përtesë
Me një rojtje në shërbesë.
Ësht i ftohur, ësht' i ngrirë,
Pa një ndjenjë, porsi i mpirë;
Dhe nga feja i verbuar,
Rron në t'errët i mbuluar.
Drin që rjeth gjith shkumb' e valë,
Her' i rrebtë, her' ngadalë,
Kur i turbullt', kur kulluar,
Kur i qetë, kur trazuar!
Që ke parë aq' të ngjara
Dhe gëzime dhe të qara,
N'aqë vjetë, aqë kohë
Dhe me diellë, dhe me llohë,
kur shqiptari i vrapuar,
Për në luftët i gatuar,
Me bałashin kryelartë
Sykulluar, sy të kjartë,

Po dëfrente, po këndonte,
Këngë trimash kur kujtonte;
Kur bari dhe blegtoreshë,
Pranë teje shumë dendur,
Fjalë, këngë kanë endur,
Kur me fyell, kur me lote,
Duk' i puthur vala jote;
Këng' e bukur, këngë malli,
Që gjëmonte i tërë zalli,
Sa edhe qelli qeshte, fliste,
Dielli, hëna rinte, priste;
Në s'dëgjohet sot u-shua
Më të çarë çdo gjë u-ndrua,
Nd'ujën tënd të valuar,
Atje brënda ka pikuar
Loti i mëmës që ka qarë
Djem të dashur q'i jan' vrarë.
Ndë atë ujët kaq' të çgryer,
Që po duket gjith' i ngjyer,
Atje brënda është trazuar,
Në çdo kohë të tmeruar,
Gjaku e djers' e ushtëtarit
Dhe të fundit dhe të parit,
Që për emër të lirisë
I dha Shpirtin Perëndisë;
Me mjaftim q'e dhuroi jetën
Për të drejtën, të vërtetën,
Për valdimin' e kombësisë
Dhe për ndër të Shqipërisë.

Ndale, ndale Drin vrapimin,
Qëndro pak e hidh vështrimin!
Rotull teje duke i parë,

Se sa janë për t'u qarë,
Viset tonë që rënkojnë,
Kur të parat i kujtojnë!
Ardhi dita pra të zgjohesh,
Si më parë ti të çohesh,
Burrat, trimat duk' i mbledhur,
Gjith me armët mi krah hedhur;
Të përpiqen, të luftojnë,
Shqipërinë ta shpëtojnë;
Zgjedhi, turpin që po e mbajnë,
Posht' ta hedhim, ta çpërlajnjë,
Sepse turp është një shërbesë¹⁾
Për atë q'e mban me besë.
Ashtu pra emrin pagëzoje
Jepi famë lartësoje.
Dëfto botës pa të druhesh,
Do se i bardhë, i zi quhesh,
Se lavdim për të fituar,
Koha edhe me s'ka shkuar,
Po sot dita Drin, të ka ardhë,
Prap' të dalësh faqebardhë!!

1912.

1) shërbesë = detyrë (këtu për *detyrimin* kundrejt shkelësit turk. Spjegim: sepse është turp të nënështrohesh, t'i shërbejsh me besnikëri shkelësit turk.



LULEKUQEJA....

Lulekuqeja e mjera
Asgjékundi s'ka shtëpi,
E shkon jetën nd' arrati,
Ajo s'është si të tjera,
S'ka stoli !

Fushës, kodrës del vetiu,
Verës ngrohet, dimrit ngrin,
Vetë shkundet, vetë mbin
Dhe kur skuqet, vjen veriu
dh' e përfshin.

Nëpër këmbë gjith e shkelin
Vend në kopshtet ajo s'ka,
Dorë ndihme kurrë s'pa ;¹⁾
As e mbjellin, as e vjelin,
shkoj u-tha . . .

Po veç ngjyra e saj si zjarri,
Si një hyll që xixëllon,
Tërë bota e imiton ;²⁾
Është shenjë për së mbari,
nga shëkon.

Ajo ngjyrë kur ze çfaqet,
Mbreti fronë shkon e le,
Njerës robër fare s'sheh,
Vjen e drejta del në faqet :
si zot je.

Ajo ngjyrë nd' ato fletë
Është shpresa që tregon
Një të ardhme që ëndëron . . .
Është flamuri ynë vetë,
që valon !



1) dorë ndihme kurrë s'pa = sepse dora e njeriut as e mbiell as kujdeset për rritjen e saj, ajo mbin, rritet dhe çduket vetiu.

2) e imiton = kërkon të bëhet si ajo.

SHQIPËRIA U-LIRUA

Shqipëria u-lirua,
Më çdo anë gazi ushton;
Me shqiponjat një pallua¹⁾
Përmi flamur po valon!

Shqipëria u-lirua,
Prej çdo vojtje sot shpëton.
Me shqiponjat një pallua
Lumtërin' po i këndon!

Shqipëria u-lirua
Shqipëtari po feston.
Me shqiponjat një pallua
Sot mi malet po ndriçon!


Shqipëria u-lirua,
Sot kur hëna perëndon,²⁾
Me shqiponjat një pallua
Reze t'arta po na çon!

Shqipëria u lirua,
Përparimi sot afron
Me shqiponjat një pallua
Kryelartë i-a kushton!

(Durrës 22 Shkurt 1914)

1) Pallua = Shpezë e bukur nga rendi i Galinaceve, me një pu-pël të gjatë mbi kokë. Bishtin e ka me pendë të gjata shumë të bukura. (I ngazëllyar për çlirimin e Atdheut nga Turqia, Poeti e shikon tërë natyrën në festë dhe bashkë me shqiponjat, atij i duket sikur është shoqëruar edhe palloj, simboli bukurisë, i gazit, i haresë).

2) hëna perëndon = «hëna» këtu është Turqia, se hëna është shenja e flamurit të Turqisë. Pra «hëna perëndon» = Turqia çduket nga Shqipëria, atdheu u çlirua nga hëna (riga zgjedha) e Turqisë.



LUFTARI LYPËS¹⁾

Lëftova për atdhe
 Lëftova për liri,
 Por veshin, një²⁾ s'ma ve,
 As dorë s'm'ep njeri.

1) Luftari lypës = ky është një nga qytetarët a fshatarët e vobegët, që luftuan me trimëri kundër Turqisë, për lirinë e Shqipërisë. Mbasi u çlirua Atdheu, pushtetin e muarnë në dorë të pasurit, që nuk derdhën pikë djerse a gjaku në luftën e lirisë. Këta, io vetëm që nuk u a njohën këtyre trimave luftën që bënë për lirinë e Atdheut, por i shtypnë edhe më keq e i lanë të vuajnë pa strehë e pa ngrënë, duke lypur rrugave.

2) një = asnë,asnjeri.

Pa kurnjë ndihmë jam,
Me plagë plot në trup,
Fuqi më t'ecij s'kam,
As rrobë s'kam mi sup.

Kudo që kam trokitë,
Një derë nuk m'u-hap.
Rri jashtë prit e prit:
Një copë bukë s'kap.

Armikut s'i jam tutë,
Në ballët i kam dalë,
Shpesh dërmën ia kam futë
Dhe hovin ia kám ndalë.

Nér nete, qiell pa hyj,
Shtërngata vij me shi,
Vend s'keshe ku të hyj,
S'di vetë qysh jam gdhi.

U-treta për disa,
Q'as njihjin komb, atdhe;
Mbi frone sot ata
Që shgryhen pa nje fre.

Me mburrje posht' e lart
Bërtasin me një zë,
Se hyjtin imu në zjarrt,
Kur zjárrí s'ishte më.

Kur isha në kushtrim
Me shokët për atdhe,
Ata gjithmon' pengim:
Çdo çap na venin re.

Kur qe ndonjë rrezik,
Disa që rrinin lark,
Sot rendin vrik - e vrik :
S'mendohen veç pér bark.

Të tjerë më shpirtliq,
Që prap na kanë vra,
Sot bëhen miq pér fiq,
Sikur më s'jan' ata.

Mundimet kush s'i njeh,
Rrezikun kush s'e pa,
Tekdo të ngopur sheh,
Q'as vunë kurnjë krah. ¹⁾

S'pyesin sot kush je,
S'kujdesen se si rron,
Kur shkon, kurrkush s'të njeh :
Syshtrembër të qëllon.

Fëmijët mos më keq,
Të çveshur un' i kam,
Të zit' t'ullirit heq,
Ndër mënd e mijë s'jam.

Përjashta, pa shtëpi
Po breth andej kötej,
Të lyp si faqezi
Fëmijët që t'ushqej.

1) Q'as vunë kurnjë krah = që nuk ndihmuani në luftën e lirisë.

Një send veç më ngushllon,
Detyrën se kam la.
Kjo helmet mi shëron,
Pa, fati-i em-m'u-pa.

; KRERËVE TRADHËTORË :

Ju njohim cilët jini, s'ësht nevojë
T'u hapet libri i veprave të bëra¹⁾:
Se populli i përmend papra me gojë;
Me kut i mat, me syt' i sheh të tëra.

Se çfarë shëmbëlltyrë t'ju përqasim,²⁾
Me ç'emër botës mundim t'ju tregojmë,
Ne, kot, si trut' e mendjen do t'i vrasim,
Me juve, e dimë, kombin turpërojmë!

Si ferrat jini, jetën q'e ndalojnë.
Çdo bim' e lule e mbytni ndenë gjëmbat,
Sa as dritë as diellë më s'shëkojnë,
As gjaku s'u lëvrin nér dejt' a rrembat!

Si bisha e malit, gjahut kur i derdhi,
As gjurmë më s'i mbetet në ka rrojtur;
Mëshirë s'kini, drojës ju nuk mverdhi
Për shpirtet, jetën që u a kini shojtur!³⁾

1) T'u hapet libri i veprave të bëra = libri ku vegjelia, punonjësit e shfrytëzuar, kanë shënuar të këqija që kanë bërë «krerët tradhëtorë», të pasurit.

2) Se çfarë shëmbëlltyrë t'ju përqasim = se me çfar shembulli t'ju krahasojmë.

3) drojës ju nuk mverdhi për shpirtet, jetën që u a kini shojtur. Ju nuk keni frikë se çdo të pësojnë shpirtat tuaj për jetën që u keni shojtur të tjerëve.

Ju s'kini as shpirt as zemër, dhembje s'ndjeni,
Pérpara jush kur krah' e duar ndehen,
Fytyrën, sytë më nj'anë iu a ktheni
atyre, shpresës suaj që ushqehen ;

Sa lot nuk janë derdhur pa shtëruar,
Shtëpi, sa s'kanë mbetur sot të shkreta ;
Sa zemra s'psherëtijnë sot pa pushuar,
Therror që ranë krejt nën 'thonjt' e imprehta !

Prej gurit zëmrën ju sikur e keni,
Që as pak s'e ndjeni qarjen e rrënkimin ;
Ju ligësit' e fajet s'munt t'i fshehni,
Çdo e keqe këtu posht e ka çpérblimin.

Mjaft, mjaft ! se u mbush kupa e hidhërimit !
Gjerprinj pushoni ! helmin tej e shporrni,
Mos dalim tej kufirit të durimit :
Që më në fund se ç'mbuallt ju të korrni !



DUA

Mbi bar dua t  prehem,
T  k ndonj t  d frehem.
T  shoh rreth bag tin ,
Kur han  edhe pin .
T  shoh fushat e blera,
Bimrat kur i frys era,
Njer zit kur punojn 
Dhe  cupat kur k ndojsn ,

Brigjet bukur stolisur,
Gjith me lule qendisur.
Pylli kudo me hie,
Që të kënda kur bie,
Dhe fletët kur përpiken,
Sytë që atje s'të hiqen.
Aq ësht e pëlqyer,
E bukur pa dëftyer,
Natyra kur përtrihet
Është punë që s'fshihet !

Hëna kur nëpër brigjet
Del si dyllë që digjet,
Dhe ndrit me ëmbëlsirë,
Çdo gjëje i jep hirë.
Natën e bën të artë
Me dritënë të zjartë,
Retë, si edhe çdo vënd,
I ngjyron gjith me ergjënd.
Sa pëlqim, sa bukuri,
Që s'e mohon asnjeri !

ЛЯКТАИ

Был написан в 1911 г.
Это из имущество одиг
Стефана Степанова
Степанов родился в 1875 г.
Стефанов о Боге в 1911
Был написан в 1911 г.
Стефанов родился в 1875 г.
Стефанов родился в 1911
Написан в 1911 г.



TRANDAFILI

Që kur në botë lulet kanë jetë,
Veç unë jam që mbretëroj mbiato,
Se un' jam luljambret.

Një tjatër vendin tem as mund ta ketë,
Se gjiret gjërë kur i hap kudo,
Me gaz kushdo më pret.

Që me t'u-gdhirë dita prëndverake
Dhe gjer sa qesh një diell dimëror,
Me mall gjithkush më çek.

Që prej kasolles s'ult' e varfanjake,
Si dhe gjer te pallati mbretëror,
Të gjith më kanë mik.

Çdo rreze, qesh në gjinjt' e mij kur derdhet,
Çdo pikë vese — e bëj margaritar,
Shpall drit' e gaz hirplot.

Kur vjeshtës, pyll e fushë nis e mverdhet
Dhe çvishet robës shelgu qamatar,¹⁾
Prap unë mbetem zot.

Gjithmon me mua bukuria mburret,
Stoli pa shëmbëll jam për çdo krahnor;
Vesoj çdo zjarr që djek.

Nuk trembem as njëj dore kur më turret,
Sepse te çdo njeri kam një dashtnor;
Me nder kushdo më prek.

Me mall si pulëp flutura vjen shtrihet,
Më puth me kraht, si mik më përkëdhel,
Si nj' i pandarë shok.

Dhe mbleta punëtore porse gdhijet,
Si prej çdo luleje meje mjaltë vjet,
Më thith e fletë-e flok²⁾

Kushdo që vjen, i kënda t'ia fal lulet
T'i prur në zemër prehje dhe gjëzim
Çdo dhembeje t'ia shëroj,

1) qamatar = vajtues. Këtu shelgu vajtues = një lloj shelg me degë të përkulura nga toka.

2) më thith e fletë-e flok = më thith edhe fletët edhe flokët

E në guxon dikush pa mënd e sulet,
T'i çjerr dorën egër pér rëmbim,
Më dhimset ta pickoj.
Jam Luljambret e paqes s'amëshuar,
Pér çdo njeri, nga zemra që më do,
Qëllimin q'e kuption;
Dhuratë qielli jam pér botën çuar,
Si shenjë butësije pér këdo,
Fatbardhësi q'enderon.

DITË PRENDVERE

Dita gdhihet, çel agimi,
Derdhet drita porsi ar,
Çduket nata, shkon qetimi,
Dielli rezet si mburimi
I çon poshtë porsi zjarr

Ndriten kodrat, fshati zgjohet
Lumi qiellin pasqyron,
Fusha, bregu ngjyra ndrrohet,
Fletët dridhen, era ngrohet;
Shkëmbi majën zbardhëllon.

Prej kasolles bagëtia
Fushës dalin pér ushqim,
Derës jashtë bukuria,
Kur ndaj kroji, kur ndaj vija,
Këngë dredh me përmallim.

Çunat lozin, vashat qepin,
Plakat e urta tjerrin lesh,
Nuset shkundin, tundin djepin,
Burrat shatën, pleqtë grepin,
Një mban fjalë, tjetri qesh.



Fushës zbresin tatëpjetë
Punëtorët në mëngjez,
Nëpër arat porsi mbletë,
Kush me veglë kush me qetë,
Me peqintë përmbi brez.

Vjen mjesdita, grat' u shpien
Buk' e gjellë me ç'u-ndodh,
Ndënë hije redhe shtrihen,
Hanë drekë, çlodhen, bien,
Pastaj nisin punën mbrodh.

Hijes gjethit miza, grera,
Zër' i zogjve redh tingllon,
Del gjahtori nëpër ferra,
Vjen bariu plot me shqerra,
Bujku çmallët e këndon.

Dita ngryset, vjen pushimi;
Dielli unjet shkon më vend,
Zhdukët drita, erdh qetimi
Hëna rezet si mburimi
I derdh poshtë si ërgjend.




P R È N D V E R A

Së largu një er' e freskë po fryn,
Qiellin e bën t'kaltërt, dhe retë i shtyn;
Malet kudo çelen lulëzohen,
Kodrat, brigjet çfaqen edhe ndrohen.

Kumbullat, gështenjat, qershítë.
Dushku, robulli e lajthítë,
Pemët të gjitha bukur përtrihi
Me flet' e lule, tek zogjtë fshihen.

Këtu bilbili këndon nëpër gjeth,
Mëllinja e gëzuar ri mi breth;
Dhe dallëndyshja rrethon, flutyron,
Qyqeja deg' mi degë vet' e qëndron,

Grërat e gjinkallat fare s'pushojnë,
Këtu cicërijnë aty këndoijnë;
Sa ëmbëlsi, sa gas i padëftyer!
Oh! kjo jetë sa qënk' e pëlqyer!



Fëmijët lozin me të përleshur,
Mi bar hidhen, kërcejnë duk' qeshur;
Dhe shqerka pas deles po blegërin
Dhe s'pushon gjersa pas nuk e arrin.

Përrenjtë me fshehje ushëtijnë,
Pikat që hedhin si ergjend ndrijnë
Dhe ujin këtu një lule kuqe,
Më tej ca vjollca me burbuqe.

Ah! ja dhe lijeni i kulluar,
Si dridhet nga era i t'holluar;
Porsi zemra, qì për çdo pikllim
Gëzohet a trishtohet me vrapi¹⁾

Ah! sa e bukur je o prëndverë,
Sa gazmend siell, sa gjëra me vlerë!
Këtu lodër, edh' atje dashuri;
Ti je jetë shpresë për çdo njeri!

1) me vrapi (gëzohet a trishtohet me vrapi) = aty gëzohet,
aty trishtohet.



PERËNDIM DIELLI NË VERË

Sa pamje e bukur e madhështore
Sa magji çfaqet që s'ka mbarim,
Natyra duket më vjershëtore
Me aqë ndryshime plot me pëlqim.

Si disk i zjarrtë perëndon dielli,
Tej reht' e malet flakë i ngjyron,
Skuqet e mverdhet përpjetë qielli
Një zjarr vollkani sikur kullon.

Si pluhur duken kur po lëshohen
Rezet e fundit me qetësi,
Dhe në kurorë të arrtë ndrrohen
Duk' u-përhapur plot me magji.

Gruri, tërshëra gjith ar ngjyruar,
Me pëshpërime tunden me vrap,
Lëndin' e gjërë me lule e shtruar
Erë prej afshi kudo përhap.

Lumi, pérroi në fytyrë ndrrohet,
Kodra edhe fusha plot bukuri;
Anës së detit po pasqyrohet
Ulliri i gjilbër me madhështi.

Rëzës bariu si gjithmonë
i bie fyellit gjith me pëlqim;
Nuset e vashat vjershës ia thonë
Nëpër kasollet me përmallim.

Sa pamje e kandëshme edh' e pëlqyer
Eshtë kur dielli po perëndon,
Ah, sa ëndra, shpresë pa u dëftyer
S'na sjell e nesërmja që afëron!

Q Y Q J A

Gjithë shpesët me fole,
Gjithë bota me shtëpi,
Vetëm qyqja mbet si qe,
Zog i shkretë edhe fatzi.

Si vjen prilli, nis këndon
Pyll më pyll e gjeth më gjeth,
Këngë-e vaje gjith' lëshon,
Tunden malet lis e breth.

Me zjarr këngës kur ja shtron,
Zemrës mallin na e nxjerr
Pylli, kodra rreth gjëmon,
Radhas kuku! kur ia merr.

Shum' i kënda, kur ia thur
Si kasnec¹⁾ i lajmes re,
Veç qe zemrën e ka gur,
Rron si murgu, s'ka fole.

Përse qyqe s'më dëgjon,
Fjalës seme s'i ven vesh?
Pse si brumbull breth, kërkon,
Jetës shijen që t'i a gjesh?

Kur këtu e kur atje
Del e zhdukesh si skifter.
Shkoj qershori, ti më s'je
Sikur bije drejt në ferr.

Ze vjen vjeshta brym' e shi,
Kohë — e dimrit me cingrim.
.Ti gjith vet' o zog fatzi
E shkon jetën në harrim.

Shih bilbilin një trupmi²⁾
Dallëndyshen gjysgjarprush,³⁾
Dhe thëllënzën ngjyrëhi;⁴⁾
Me folenë si gjithkush.

1) kasneci-i = lajmtar.

2) trupmi = me trupin sa një mi.

3) gjysgjarprushë = që i ngjanë gjarprit në trup (gjysëmgjar-për).

4) ngjyrëhi = që e ka ngjyrën e trupit si atë të hirit.

Ndo lavroshën¹⁾ krahëshpejt'
Shkurtë-e turtull a po çdo?
Ndo mëllinjën kembëndrejt;
Palë, palë — i sheh kurdo.

Ve ti pjell e ve ti s'ke,
Rron e lirë — e pa kujdes,
Zogjt' e tu se ku i le,
As të hyn ndopak në thes.²⁾

S'të ka hije qyqe-aspak,
Kurse mëndjen nuk' e shtron,
Çdo gjë-e gjallë që ka gjak
Mbi dhet posht.³⁾ e vetëm s'rron!

1) lavroshën = shpezë grabitqare nga familja e Fajkojvet, që ushqehet me kërmë.

2) as të hyn ndopak në thes = nuk të intereson fare.

3) mbi dhet poshtë e vetëm s'rron = poshtë mbi dhe, nuk rron e vetme, por çift, në familje.



PAMJE VJESHTE

Shkoi vera
Si hije,
Frym' era,
Shi bije.
Lart qielli
Si plumbi,
Shkoi dielli,
Na humbi.
S'ka jetë,
Ra brymë.
Bar, fletë
Pa frymë.
Rri zogu

Të hajë
Te shtogu
Mi majë.
Ka gojë
Do jetën,
Ta rojë
Të shkretën.
Gjahtari
Del gjahut,
Druvari
Dru krahut.
Del bujku
Mbledh berrat,
Tej ujku
Nër ferrat.

V J E S H T A

U çduk vapa, shkojti vera
Dhe bilbili më s'këndon,
Ardhi vjeshta me të tjera,
Syri i ynë q'i shëkon.

Terret koha, hapen retë
Ngjyrë plumbi përsëri,
Duket prapë tjetër jetë,
Që natyra ndron tashi.

Era fryn, dhe fletët bien,
Pemët çvishen si ngamot,
Mali, fusha më s'ka hijen,
Që po e kishte gjer më sot.

Qielli i bukur që dëfrente
Trupin tonë, sot u-terr,
Më s'ka ngjyrën që shkëlqente
Si pasqyrë, si mermer.

Bukuritë janë çdukur,
Shiu e bryma zuri vënd,
Bari, lulet, kopshti i bukur
U-ndryshuan më çdo kënd.


Dhe lijeni i kulluar,
Që ndriçonte me shkëlqim,
E ka faqen të trazuar,
Dridhet, tundet pa pushim.

Veç nga herë më ëmbëlsirë
Dielli rezet na i dërgon,
Natën hëna me një hirë
N'ërgjend malet i ngjyron.

Por e mirë është vjeshta,
Sepse bujku gjith punon :
Për të vjelur sot ka vreshta,
Nesër arat po lëron.

Njerëzia nga çdo anë
Posa ngrihen në mëngjes,
Nëpër fushë çdo që kanë
Redin, mbledhim me kujdes.

Pra me punë gjith të rojmë,
Se veç puna ne na vlen,
Sepse ndryshe s'trashëgojmë
Verën tjetër që po vjen.





D I M È R I

Pylli më s'gjelbëron,
 se nga fletët u-shkund,
 As era më s'pushon,
 po shpesh degët i tund.
 Dallëndysheja shkoi,
 si na gjëzoi n'verë,
 Ah! dhe qyqja pushoi,
 vajti në shkëterrë.
 Fluturat më s'venë
 nëpër lule me qëndru,
 Çdo gazmënd e lenë
 dhe trishtim' i ka pushtu.
 Hëna nukë shëndrit,
 se ret' e kan' mbulu;
 Veç ngaher' rezet i qit
 porsi vash' e turpnu.

Era, fryn, bie shi,
veriu vërvhëllen,
Vjeshta ikën tashi
dhe dimri me vrap vjen.
Dbora flokë, flokë
të gjitha i mbulon,
Sikur s'je ti o tokë,
sa bukur zbardhëllon !
Zogjtë togje, togje,
për me kërk u shqim,
Zihen nëpër shtogje,
kur hanë me nxitim.
Dbora zbardhi malin
dhe fushën tatëpjetë,
Njerëzit më s'dalin
dhe rruga është e shkretë.
Kudo është pushim
dhe heshtje mbretëron,
Veç veriu me tërbim
përpjek edhe rrëzon.
Hoho ! pusho o veri,
mjaft, mos vërvhëlle,
Ku qe ec' përsëri
dhe prapë mos u-kthe !
Prëndvera për me ardh
me ditë të gazmume,
Fushën me na e zbardh
me lule t'bekume.
Eja pra o lule ¹⁾,
që rrites ndë vesë.
Ti nga qiell u-sule,
për me na pru shpresë.

1) Eja pra o lule = lulja e parë që çel në të hyrë të prandverës



Ditën e veshja siko, fëmijët
Vet e qytetarët që qëndron
Ahi, dhe qyqja ëbris om rëq më shpërthi
Flutur, që bëhet a që që mëdani
ARDHJA E DIMRIT

Zunë ret' edhe po shoshen,
Dbora bie me qetim,
Dheu mbulohet në të bardhë.
Me një robë plot shkëlqim.

Bien flokët si pambuku,
Sërë, sërë e një nga një,
Bëjnë vetulla mi muret,
Ndron fytyrë posht' çdo gjë.

Zë fryn era pa pushuar
Del veriu me tèrbim,
E ngreh dborën porsi pëndë,
E bën togje me nxitim.

Çduket fusha an' e mb'anë,
Në syt' duket porsi det.
Përtej lumi ndrit si ërgjëndi,
Porsi gjarpër rrethon, shket.

Dridhen zogjtë nga të ftohtit,
Porsi fleta ndënë shi,
Kur foleja majës shelgut,
Që t'i mprojë s'ka fuqi.

Në fshat ditën duket heshtje,
Sipër tymi veç rrethon;
Për m'at' anë dushku i vogël
Po tunt kryet e vajton.

Në kasolle plaka e zbardhur,
Pranë këndit po tjerr lesh.
Vështron flakën që del zjarrit,
Lark menjtohet . . . loton shpesh.

Del e reja në dritatare,
Në gjit foshnjën përkëdhel
Dhe një këngë mjalt e ëmbël
Duk' e puthur, gojës del.

Jashtë çunat hidhen, lozin,
Gjersa urija i largon;
Ndenjur shtratit vash' e bukur.
Duke ëndur po këndon

Natën fshati fle në prehje,
Kudo paqe mbretëron,
Ndër kasollet ënden ëndra:
Shpresë jete që s'shtëron:

Zunë retë prap' të shoshen,
Dbora bie me qetim,
Dheu mbulohet në të bardhë,
Me një robë plot shkëlqim.

1) deperton = përshkon.



STINAT

Shpallet dita,
tretet nata,
Çfaqet drita,
Zgjohet opata.

Hapet qielli,
Çohet reja,
Bije dielli,
Del kopeja.

Mvishet shkëmbi,
Çilen ferrat,
Ritet gjembi,
Mahen shqerrat.

Lihen gunat,
Thuret mali,
Lozin çunat,
Hidhet kali.

Ndrit liqeni,
Lahet rosa,
Turret qeni,
Mpreheth kosa.


Skuqen thanat,
Piqet gruri,
Shkunden manat,
Çvishet druri.

Vilet rrushi,
Mverdheth fleta,
Dridhet bushi¹⁾,
Pshtillet jeta.


Thahet bari,
Theren berra,
Ndizet zjari,
Pihet vera.
Frym murllani,
Zbardhet bregu,
Dergjet stani...
Zihet shtegu.

1) bushi = nji lloj druri.

Mbylllet porta
 Çelet enda,
 Zbrazen shporta,
 Thyhet penda!...



SUPERIOR CHITARRA
 Tot zappelhart si naga mott
 Po zapplez uha j' meddien
 Na kurti uha j' meddien
 Dje caszjé ppezzien
 I pieri eiss u' sol
 Lard avon dher hispdiem
 E dherzies dherzien dherzien
 E dherzien dherzien;
 Lard dherzien dherzien j' meddien
 Kärtziening għad idher j' meddien
 Bier il-kunċċejha u l-piċċu
 Per solu u biegħi
 Mi qed u war idher jidu
 Kexxien u x'ebba leżżeppien
 Minnien għadde tibbi u
 sej̊ fuu qiegħi u
 kif kien kollu u
 kif kien kollu u



SHPESËT UDHËTARE

Tok mbledhur si nga mot
Po shkojnë ndaj mërgimi,
Nga kulmi, nga largimi,
Na lenë «lam' tu mirën»
Dhe çajnë hapësirën,
I bien erës m'not.

Larg venë për ushqim,
E nxijnë qielin, ngasin
Ethirit¹⁾ sipër shkasin;
Vjen dbora, dimri i mprehtë,
Kërkojnë vënt të nxehthë,
Plot shpresë dhe kuxim.

Për gojën pa përtim
Mi dete, male shkojnë,
Rezikun s'e peshojnë;
Mundim edhe të vojtur,
Se jeta duhet rrojtur,
S'ka prehje as qetim.

1) e thirit = eterit, nëpër eter, nëpër hapësirë.

PËR GJAH

Dyfekët për brezi
Dhe pushkën mi krah,
Pa zbardhur mëngjezi
Të dalim për gjah !

O burra bre shokë,
Rreth hapur të gjith,
Vënd zini mbi tokë,
Lart malit më vith

Thëllënza edhe rosa,
Dhi t'egra mjaft ka ;
Arinj, derra, dosa,
Sorkadhe si ka.

Nosita edhe shkurta,
Plot turtuj në gjeth,
Verdhashka të urta,
Kot plumbin s'e heth !

Bam, bum ! të kërcasë
Drejt plumbi mi 'to,
Mbërdhe sa t'pellasë ;
Mer gjahun dhe shko.

Me krahtë ngarkuar,
Gjithkush në shtëpi ;
T'i hajë i gëzuar
Për ditë nga tri.



PUNËTORI I MIRË

Ngrihet që me natë,
Pa dalë mirë dielli,
Merr që edhë shatë,
Pa u-zbardhur qielli.

N'arë vete me gas,
Punon me dëshirë
Dhe dreka si u qas,
Ha edhe pi mirë.

S'trëmbet kur fryn era,
As shiu kur pikon,
Se këtu ësht vlera,
Për atë që punon.

Punën si e mbaron,
Që djersa i rjedh
Dhe djelli perëndon,
Ay veglat i mbledh.

Mbrëmanet në shtëpi
Nga puna vjen, çlodhet,
Merr fëmijën në gji
Edhe ha ç'të ndodhet.

Vreshtën e ka kujdes,
Bagëtin' e ushqen,
Pa miell nuk' ri në thes,
Të gjitha mir' i kthen.

Vjeshta kur afrohet,
Ay shtëpin' e mbush
Dhe rri e qetohet
Pranë zjarrit me prush.

Sa gëzim ay ndjen,
Kur ka se ç'i duhet;
Dimëri i pëlqen
Edhe kurrë s'huhet.

P U N A

Kujt s'i pëlqen të punojë,
Ay s'mund të quhet njeri,
Se kërkon gjithë të rronjë
Me gënjeshtra e djallëzi.

Puna e nderon njerinë,
Ajo i sjell fatbardhësinë
E ka plot edhe shtëpinë,
Kurrë s'mbetet me dor' më gjil.

Shumë jan' ata që rrinë...
Dhe fëmija vdes urije,
Po të vështrojnë shtëpinë,
Mbarësia larg i shpie.

Natyra ka mjaft dëftime,
Që na mëson si të bëjmë;
Që për ne janë burime,
Me mëndjen si t'i çbëjmë ¹⁾

Shpezët, kafshët nat' e ditë
Gjithë përpiken për ushqim,
Edh'i kanë plot shtëpitë,
Sepse punojnë me mundim.

1) t'i çbëjmë = t'i zgjidhim, t'i gjejmë.

Ashtu dhe ne të punojmë,
Si duhet mirë pér ushqim,
Begati të mos lakojmë,
Se edh' ajo sjell hidhërim²⁾.

2) Poeti ishte kundër të pasurve dhe pasurisë së tepërt, se s' dinte që lakkia pér pasuri sa më të madhe tek disa ishte shkaku i mjerimit pér gjithë punonjësit. Kjo ishte një dëshirë e mirë e Poitet, por në shoqërinë kapitaliste nuk mund të frenohet lakkia pér pasuri, as mjerimi e shfrytëzimi i shumicës së popullsisë prej pakicës së pasur.

II. P R O Z A

MËSUESI IM

Në katundin tonë kishim një mësues, ose «dhaskal», siç i thojshin ahore, i cili na mësonte greqishten, se n'atë kohë gjuha shqipe nuk përmendej aspak, për ta mësuar në shkollë.

Isha atëherë djalë 9-10 vjetsh edhe megjithqë jeshe i vogël, prap qëndronja në krye të çdo kllasse, si një që e mësonje mathimën ose mësimin gjithënjë mirë, sa më mundej.

Ky dhaskali ynë, ose mësuesi, siç i thonë sot shqip, ishte një burrë i gjatë prej një katundi t'afërmë, i mvrejtur e thatanik, me ca syza nga ato që janë me qelqin e thurur përbrenda me një farë site mbrojtur nga pluhuri, aq sa të mos dukeshin sytë aspak. Kjo nga shkaku se kishte një të metë në sytë, me që vështronte vetëm me një sy, se tjetrin e kishte humbur kushedi sesi dhe, që të mos i dukej nëpër syzat ky shëmtim, qelqin ia kishte vënë të zi, ashtu që shëkonte vetëm me të shëndoshin, që e kish me qelq të kulluar. Syzat i kishte të lidhura me një farë gjalmi prapa kresë përmbi veshët.

Emërin i a thojshin Mito Panajot, por më tepër qe i njojur më mbiemrin «Verdho». E dinte mirë greqishten në mos fare të përsosur, por përfshatin tonë që ay më i dituri. Për ndonjë fjalë më të rëndë¹⁾, që nuk e kuptionte mirë, kish

1) fjalë = më të rendë = fjalë më të vështirë.




një fjalor greqisht, nja katër gishtarinj të trashë, në të cilin e kërkonte shpjegimin e duhur.

Duke patur një fytyrë të mvrejtur, siç na dukej neve nxënësve, kishte edhe një sjellje t'ashpër fort pér ata që nuk mësonin, sa, pér çdo gabim të bërë në mësimet, ndeshkimi ish i rreptë.

Ashtu pra, pér ndeshkimin e fajtorëve, kishte dhe purtekë të dyfishme, domethënë dy purteka të lidhura me gjalmë në mes, që të jetë e gjatë edhe t'arrijë që nga kathedra gjer në vendin e fundit, pér t'u-rënë mbi duart atyre nxënësve që nuk rrjin urtë.

Kur na nxirrte të na dëgjonte mësimin (mathanin), atij që disa herë nuk e dinte ta shprehë



ARIU, QENI DHE MACJA

P e r a l l e

Ishte një herë në një fshat një njeri, i cili kishtë një qen. Po ardhi koha që ay qeni u plak aq sa s'munte të lehë sindëkur¹⁾, ishte i ri, më s'munte të ruante gjithë me atë besë hambaret me bukë edhe tërë kamjen²⁾ e të zotit të tij. Atëherë njeriu ynë e merr me një shkop edhe e nxjer jashtë portës, duke i dëftyer udhën e madhe, të vejë nga të dijë.

Qeni vate gjer më një pyll. Atje shtrihet ndën një lis edhe po priste të vdiste nga uria.

1) Sindëkur ishte i ri = si ahere kur ishte i ri.

2) kamjen = pasjen.

Atë kohë një ari shkon pranë tija dhe e pyet:

— Or qen, pse u shtrive këtu?

— Ardha t'i le shëndet kësaj jete në këtë pyll.

Veshtro ç'do me thënë e drejta nga anë e njerzvet: sa kohë kanë nevojë pér ty, nuk dinë si të tē mjaftojnë¹⁾ me çdo gjë, të të kënaqin, por posa umplake, të flakin jashtë oborrit:

— Tashì mund të jesh i urëtuar²⁾ edhe do që tē hash gjësendi!

— Po më pyet akoma? Kam dy ditë që s'kam ngrënë gjë.

— Haj me mua, se unë do të jap mjaft pér tē ngrënë. Shkuan bashkë. Mb'udhë hasnë një kalë.

— Ja vështromë, i thotë ariu qenit.

Edhe zuri tē rrëmijë dhenë me thonjt e tija tē fuqishme.

— Or qen!

— C'ësht' or byrazer³⁾?

— Ja vështro, u skuqnë sytë e mij apo jo?

— U skuqnë or byrazer!

Ariu rrëmin dhenë më me fuqi akoma.

— Or qen, ja vështro, m'u ngrit leshi i shpinës përpjetë?

— U ngrit, vëlla ari!

— Or qen, po bishti im a rri përpjetë?

— Ho, ho, rri, si jo!

Ariu ndalohet së rrëmuari dhe përnjëherë i sulet kalit dhe i nxjerr zorrët jashtë. Kali bie mbërdhe edhe ariu e bën copë-copë.

1) tē mjaftojnë me çdo gjë = tē apin çdo gjë, mjaft, sa tē keshë nevojë.

2) i urëtuar = i uritur.

3) byrazer (turqisht) = vëlla.

— Tashi or vëlla qen ha sa ke shije (oreks). Edhe kur të jeshë prap në nevojë, eja edhe më kërko, dëgjove?

— Të ngjatjetoj me të tepër, or vëlla ari!

Qeni ja shpuri mirë shumë kohë; po një herë gjithë u mbarua ajo gjellë, ahere shkoi të kërkojë arinë.

— Çë or vëlla, e hëngre të tërë?

— Edhe kockat pothuajse i qërova dhe tashi po xvarrosem e më s'gjej fare dhe po vdes urije!

— Mirë. Di ti ku korrin gratë e fshatit në arë?



— Si të mos e di?

— Ahere haj andej. Unë do të vij fshehtazi ngadalë, ngadalë gjer afër shtëpisë, do të hyj bren-
da e do të vjedh foshnjën e sat'zonje. Ti të ren-
dësh pas meje edhe të ma rrumbesh foshnjën e
pastaj t'i a shpriesh në shtëpi. Ke për të parë pas-
këtaj sa mirë do të rrosh edhe si do të shkosh më
tët zonjë.

Ariu hynë fshehtazi në shtëpi edhe merr fosh-
njën nga djepi. Foshnja zu të lebetitet. Gratë që
korrnin e panë këtë të ngjarë ¹⁾, i sulen pas ariut.
po këthehen prapë, pa të mundin të shpëtojnë fo-
shnjen. E mjera nënë u vra së qari. Edhe gratë e
tjera po vajtonin për të keqen që e gjeti. Po, vër-
njëherë kërcet ²⁾ qeni — nuk dihet se ngaha —



1) të ngjarë = ngjarje.

2) kërcet qeni = del me të kërcitur, me të lehun.

rendën me të katrat, që t'arrijë arinë. Si e arriti ia merr foshnjen dhe e siell në shtëpi. Që të gjithë i duallë përpara. Mëmën nuk e nxinte vendi prej gazit.

Kurrë s'e kam për ta larguar këtë qen nga shtëpia ime. Pastaj i thotë shoqit të saj :

— Burrë, ta kemi kujdes këtë qen si sytë e ballit, ay na shpëtoi foshnjën nga thonjt e ariut. Edhe ti thojshe se s'i bën lëkura dy para.

“Qeni, as kur ishte në barkun e sëmës nuk rrόnte më mirë se tashi. Ishte ngjallur aqë sa më s'njihet më. «O zot, thoshte shumë herë, jepi shëndet ariut, sepse vetëm ay më shpëtoi më ditë që s'më mori djalli nga urija»¹⁾.

— Bëri miqësi paskëtaj me arinë, sikur ishin dy vëllezër prej gjaku.

* * *

Një ditë katundari ynë kishte bërë një gosti (zjafet). Njeriu²⁾ kishte ftuar disa miq e bashkë po hanin edhe pinin si në dasmë. U ndodh që ariu ardhi atë ças të shohë mikun e tij.

— Mirëse të gjeta, or byrazer, si vete, je shëndoshë e mirë?

— I falem perëndisë dit' e natë, se jam mirë or vëlla. Kur të jem më liksh, të jem ashtu si jam tashi. Po ç'nder do që të bëj me që urdhërove tek mua? Haj të hyjm në shtëpi. Zotërit e mij hanë e pinë në një dasmë, janë në qejf e sipër

1) sepse vetëm ai më shpëtoi më ditë që s'më mori djalli nga uria = sepse vetëm ai më shpëtoi atëhere kur s'më mori djalli nga uria.

2) njeriu = për fshatarin e ka fjalën këtu.

e nuk do tē ndjejnē se hyre brenda. Futu sa mē shpejt nē kêtë musandër (dollap tē math).

Hynë që tē dy. Qeni e nderoi, e qerasi mikun me një kupë verë edhe me një edhe me një tjetër, ashtu ca mē tutje¹⁾. Nē shtëpi mysafirët nisnë tē



këndojojnë. Ariut i ardhi edhe 'atij qejfi tē këndojojë.

— Tē mos tē vërë nema tē nxjerrësh²⁾ zënë, se na mori djalli që tē dy.


1) ashtu ca mē tutje = kështu vazhdimisht.

2) tē mos vërë nëma tē nxierrësh zenë = një qortim miqsor i genit që e urdhëron arinë tē mos bërtasë.

Po ariu që ishte pak i dehur nga e pira, nuk deshte t'i peshonte këto fjalë të qenit. Nisi t'ia thotë¹⁾ më parë ngadalëza, pastaj e ngriti zënë, gjersa ndjenë ata të shtëpisë. Atë ças u sulnë që të gjithë mbi te, ashtu që i mjeri ari mezi shpëtoi më tepër i vdekur se sa i gjallë.

* * *

Në shtëpi të këtij katundari na qenka edhe një mace. Kjo më s'deshte të zinte minj, po bënte njëmij marrëzira. Një herë përbyste enët dhe pjatat që ishin mbi një police²⁾, tjetër herë derdhte qumështin nga poçet. Atëherë fshatari ynë e mori edhe e përpoqi një herë dhe e hodhi jashtë. Sa herë macja kthehej, ay e përzinte.



1) nisi t'ia thotë = nisi t'ia thotë kangës.

2) police = sergjen (turqisht). Një raft i gjerë në guzhinë, si nja nji mëtër i lartë nga dyshemeja, ku vihen enët e shtëpisë kryesisht enë' e ushqimit.

Qeni duke e parë macen kështu që mezi mba-hej më këmbë nga taria vidhite nga shtëpia e të zotit bukë edhe mish, që t'i japë së mjerës mace të dbuar. Po, e shoqia e fshatarit e vuri re këtë gjë dhe zuri ta rrahë qenin, duke e qërtuar keq për bënjet¹⁾ e tija. Pas nja tri ditsh pas të rra-hurit, qeni dolli të shikojë ç'bën vallë mikesha e tij, të cilën e gjet se po jepte frymën e fundit.

— Asnjë kapshitë s'kam venë në gojë, maju-nis²⁾ ajo, që kur pushove ti të më sjellësh të ngrënë.

Haj me mua, i thotë qeni.

Ikën. Qeni afrohet në një hergjeli³⁾ me kuaj edhe ze të rrëmijë dhenë me thonjtë.

— Mace, mace, pa më thuaj, janë të kuq syt' e mij?

— Jo, s'janë të kuq vëlla qen.

— Thuaj moj e prishur⁴⁾ se janë të kuq.

— Mirë, janë të kuq.

— Mace, mace, m'u ngrit leshi i shpinës përp-jetë?

— As ndër mend s'e ka.

— Thuaj moj e marrë se u ngrit.

— E mirë, u ngrit.

— Mace, mace, po bishti a rri përpjetë?

— Ç'më pyet or vëlla? nuk duket fare të jetë përpjetë.

— S'paske fare mend. Thuaj se ësht' ashtu, kupton?

1) bënjet = sjelljet.

2) majuris ajo = thotë ajo.

3) hergjeli (gr.) = haur.

4) e prishur = e prishur menjç, e çkalluar.

— Mirë, të thom, që të rri përpjetë.

Aherë qeni i hidhet me një sulm një kali, po kali i bije një herë me shqelm dhe e dërgon n'atë jetë¹⁾ në çast.

«E», tashi veshtroj edhe unë, se t'u skuqnë sytë, t'u ngrit leshi i qimes përpjetë edhe bishti po tundet në erë. Mbeç me shëndet vëlla qen, se tashi edhe unë do të vdes.



1) e dërgon n'atë jetë = e ngordhi, e la në vend.

(Një djali)

Nuk është ashtu djalë, se ti e do gjuhën e vendit tënd? Ajo dihet, se ti e do. E duam që të gjithë. Dashuria për gjuhën tonë është e pandame nga ajo ndjenjë çuditje dhe mirënjohtje që duhet të kemi për stërgjyshërit tanë, për thesarin të pashterur të ditjes²⁾ dhe të bukurisë, të cilën ata i dhanë njerëzisë me anë të gjuhës dhe e cila i siell famë vendit edhe ndër emrit tonë në gjëresi të botës. E duam se me të brumosurit³⁾ e saja u munduan sërë stërgjyshësh, miljona punitore të panjohur një gjak me ne, që e begatuan⁴⁾ ditë me ditë, që na e dorëzuan neve me besë, si atë me të shtrejtin trashëgim, në të cilin ata derdhnë tërë mendjen e tyre. Edhe shorti⁵⁾ i gjuhës, djalë, është shorti i atdheut, gjallërimi edhe historia jonë, bukuria dhe shkëlqimi ynë. E duam sepse çdo fjalë e saj mburon nga thellësi e përbrendëshme e shpirtit tonë bashkë me ndjenjën e me mendimin tonë. Edhe s'është vetëm roba me të cilën mveshim të menduarat⁶⁾ tona, por është qenja e vetme e mendjes sonë. E duam sepse është mburim ushqimi i shpirtit tonë, është rrjedhja e natyrëshme e mendjes dhe ndjenjës sonë, përfytyrimi besnik të çdo që kemi të

1) Përkthim i Asdrenit nga «L'idioma gentile» e E. de Amicis.

2) të ditjes = të dijes, diturisë.

3) më të brumosurit = me brumosjen, me formimin e saj.

4) e begatuan = e pasuruan.

5) shorti = fati.

6) të menduarat = mendimet

ndryshme në të qenurit tonë kombiar¹⁾, kora më e gjallë dhe më e drejtë e fisit tonë. E duam, sepse ajo është lidhja më e fuqishme e bashkërisë sonë si komp, është mbështetja e patundëshme e rrojtjes sonë edhe lajmëtari, që na vjen nga kohët e shkuara, ruajtësi që na drejton për të ardhmen tonë.

Por e duam edhe, o djalë, për aqë bukuri, për aqë begati edhe për fuqinë që ka në të. Është aq e lehtë për t'u përdorur gjuha jonë edhe aq e plotë në fjalët e në të folurit e saj, sa mund edhe të bënje dredhje edhe forma pambarim, të apëngjyra shumë të pëlqyeshme, të çfaqësojë²⁾ fëtyrat, ato më të rejat e më të kuximshmet. Është posa një dhe pjellor i ngrohur prej një pren vere të përjetëshme. Tërë lulet që mbijnë prej tij, janë plot risi³⁾ bukurije dhe shëndeti. Prandaj, djalë gjuha jonë ësht' e lëvduar dhe e zilepsur⁴⁾ edhe prej kombeve të huaj. Neve e duam më te-për se kushdo, dhe e duam për atë bukurinë e fshehtëshme, e cila vetëm neve na zbulohet e të cilën vetëm neve e kupëtojmë.

Fjalët e saj, djalë, kanë për ne interes të veçantë, një harmoni të fshehtëshme e të padishimtë prej të tjera, se na përmend në shpirt tanë kujtime për vende që i kemi parë kush e di se kur, për njerëz që rrojtnë dhe shkuani, na përmend fëtyra, vjerrsha dhe ndjenja vjershëtorësh

1) të qenurit tonë kombiar = qenjen tonë kombtare, qenjen tonë si komb.

2) të çfaqësojë = të çfaqë.

3) plot ris bukurije e shëndeti = plot bukuri e shëndet rinuer.

4) e zilepsur = e parë me zili.

e shkronjëtorësh të pavdekshëm, të cilët, në rje-dhje të shekujve u bënë një me shpirtin dhe me gjakun tonë. Ajo është për ne muzika e dhëmbjes, e gazit dhe e dashurisë për atdheun, plot me fu-qira të padukura, e me mallëngjime të fshehtësh-me, të cilat dridhen edhe mbijnë n'ato me të thellat anëza të zemrës seme. E vështro, djalë, përandaj neve e duam gjuhën tonë, sepse është zëri i zemrës sonë, është drita e mendimit tonë.

Ta njohim gjuhën tonë

Posi do të mundim neve, o djalë, ta duam gjuhën tonë, në mos kërkofshim më parë ta më-sojmë? Si mund ndokush të dojë një gjë që s'e njeh, të dojë një send që nuk mund ta çmimojë? ¹⁾ Vall është edhe për dashurinë, po edhe për të duhemet ²⁾ e nevojat e jetës sonë? Mendohu pak! Më çdo anë të vendit tonë të jesh lindur ti, kur të marësh pendën në dorë, ke detyrë t'i për-shkrosh mendimet edhe ndjenjat e tua në gjuhët tënde. Me mij dhe me mijë herë duke shkrojtur e duke folur do të ndjesh nevojën si të dëftesh dëshirat edhe pësimet tënde, të lëkundësh ndjenjën edhe vullnetin e të tjera, të tregosh, të vërtetosh një gjë, të lutesh, të çfajtohesh ³⁾, të mbrohesh. Edhe si do të mundesh të dalësh faqe-bardhë nga tërë këto, po të mos e njohësh gjuhën tënde ashtu siç lipset ta dish. Gjithënjë do

1) që nuk mund ta çmimojë = që nuk mund ta çmojë.

2) të duhmet = nevojat.

3) të çfajtohesh = të çfajsohesh.

të ndjesh një rëndësirë edhe një si turp, sa herë që nuk do të jesh i kupëtuar, sa herë që nuk do të mundesh të thuash ashtu si dëshëron, atë që ke për të thënë. Do të të duket atëherë se ke në dorë një llahutë (violi), që nuk të dëgjon dhe nuk mund të nxjerrësh soje asnë tingëllim pas dëshirës së zemrës. Ke për të ndjerë se, një an' e madhe e ndjenjave të tua më të thella e më të shpirtëshme, nga besimet e mendimet e tua më të paqme, mbeten të panjohur për të tjerët, prej ngajes¹⁾ së një së folme pa kripë, një së foline që i mungon fuqia edhe gjallëria. Ke dëgjuar të thonë, se shumë njerëz nuk mundin të hapin një udhë në jetë të tyre vetëm e vetëm se u mungon fuqia që të bëhen të kupëtuar.

Sa herë në jetë tanë një humbje e rëndë apo një dobi e madhe nuk mvaret nga një mendim apo nga një ndjenjë e jonë, treguar a dhenë në mënyrë të keqe a të pakuptuar, po përkundrë të faqësuar²⁾ a të dëftyer me një formë që depërt³⁾ tërë shpirtin edhe vete drejtpërdrejt në mendjet e në zemrët të atij që i flasin. Sa njohje e sa ide nuk mbeten të mshehura për gjithë një në mendjet të disave, si një begati e mbuluar në dhet, pa ndonjë vleftë, vetëm e vetëm se zoti i tyre nuk është gjith' n'atë kohë edhe zoti i një gjuhe me të cilën të muntnjë të kupëtohet me ngjamësit⁴⁾ e tij. Thonë se njeriu vlen aqë sa

1) prej ngajes së një së folmes = nga shkaku i një së folmes.

2) të faqësuar = të shprehur.

3) depërt = përshkon.

4) ngjamësit e tij = ngjajëshmit e tij, njerëzit e ngjajshëm me të.

di. Po me një masë më të madhe vlen edhe sipas mënyrës pas së cilës ay e thotë atë që e di. Tani, më tepër se kurdoherë, të njohurit siç duhet i gjuhës, është një dobi e paanëshme¹⁾, sepse lidhjet e dhënëmarjet midis njerëzve janë më të shtërnguara edhe rasjet në të cilat kemi nevojë që të çfaqim e të dëftejmë mendimet tona, më të shumta e më të shpeshta.

Gjuha, djalë, s'është vetëm një stoli e mendjes sonë, po gjithë n'ate kohë është edhe një ar më lufte në jetët të përditëshme, fuqia edhe passja e shpirtit tonë, është çelës i zemravet dhe' i vetëdijevet, është vegla e punës edh' e fatbardhësisë.

* * *

Po duhet edhe që ta mësojmë gjuhën nga detyra si qytetarë²⁾. Gjuhët çkëmbehen edhe çpërbëlehen në rjedhje të kohëvet, ashtu si çkëmbhetet çdo gjë. Ato fitojnë fjalë edhe tingllime të ra, porsi edhe drurët që ndrohen për çdo vit me fletë të rea edhe të freskëta. Disa fjalë humbasin, të tjera e këmbejnë kuptimin. Është një nim³⁾ i natyrës, në virtut të të cilit⁴⁾ gjuhët çpërbëhen në qenjet e në të endurit e tyre⁵⁾. Po

1) dobi e paanëshme = dobi e madhe shumë, pa anë, pa fund.

2) ta mësojmë gjuhën nga detyra si qytetarë = si qytetarë na jemi të detyruar ta mësojmë gjuhën.

3) nom = ligj.

4) në virtutë të të cilit = në bazë të të cilit, sipas të cilit.

5) gjuhët çpërbëhen në qenjet e në të endurit e tyre = gjuhët çpërbëhen (pësojnë ndryshime, ndryshohen) në qenjet e në të endurit e tyre (në përbërjen e në strukturën e tyre).

vështro. nuk duhet të besojmë, se ky çkëmbim i natyrëshmë dhe i pandaluar i një gjuhe, është një me vdirrjen¹⁾ e saj e me prishjen e saj, e cila dëften të hyrit e fjalëve të huaja në te, që s'i përkasin fare asaj e të cilat nuk sjellin asnje dobi. E mirë, detyra jonë është që ta ruajmë gjuhën nga të këtilla shëmtimi. . . . Është një punë shumë e keqe që të lëvdohesh se e do atdhenë, sa kohë ti shëmton edhe ndynë gjuhën tënde. Gjithë për atë fjalë, për të cilën kemi detyrë të nderojmë edhe të ruajmë me sa të na mundet atë begati pambarim që na mbeti nga prindërit tanë, kemi detyrë të nderojmë edhe të ruajmë trashëgimin e gjuhës, të cilën na e dorëzuan neve me besë, porsi një talisman²⁾ lavdije edhe të cilën më radhën tonë³⁾, duhet t'ua dorëzojmë fëmi-jëvet tanë të pangashme⁴⁾ dhe të pandryshuar.

Dashuria e atdheut pra, kryelartësia kombëtare dhe detyra jonë qytetare, nevojat tona edhe të sicilit veçanërisht, si edhe dobia e fitimit e të gjithëve, kërkon që të mësojmë gjuhën, cilido që të jetë vendi ynë në shoqërit, cilado që të jetë dhanëmarrja jonë më çdo anë t'adheut u lintmë dhe rrojmë. Duhet ta mësojmë, sepse atdhe edhe gjuhë ndjenjë edhe fjalë, fjalë edhe jetë, nuk janë tjetër përveçse ajo gjë.

1) me vdirrjen = me humbjen, shkatrrimin.

2) talisman (fjalë greke) lavdije = gjë shumë e vyer lavdije, që ruhet me kujdesin më të math.

3) më radhët tonë = na të kësaj radhe, të kësaj gjenerate.

4) të pangashme = të paprekur të paprishur.

ËNDËR E VËRTETË¹⁾

Shumë herë mejtohesha : Vjete shumë shku-an që kur e kam lënë Shqipërinë. Isha djal i vogël kur ika, po ashtu si isha, sikur kuptonja, sikur ndjenja gjëkafshë të fshehtë, që herë më gëzonte, herë më trishtonte pamasë. Djalë mali e fushe. Natyra ish më e para punë që më dëfrente zemrën, që më kënaqte sytë, që më hirështonte²⁾ shpirtin, prandaj një të madh trishtim ndjeva kur e lashë.

Në dhe të huaj i vajtur, domosdo u mësuash me zakonet e vendit, të cilat piksëpari më duke-shin shumë të çuditëshme. Jeta e qytetit, e shkollës padышим të ndryshon, të hollon, të këmbejn. Atje njeriu siç sheh ashtu bën : ze tjatër udhë, udhë që një të huaji mund t'i sjellë shumë të mira, po edhe shumë të liga.

Vjetet ridhnin parreshtur, koha shkonte, ajo kohë që i këmbejn të gjitha, që i harron të gjitha, që i ndryshon të gjitha. Po mbi tërë këto, një dëshir e brendëshme e zemrës më shtynte, më shponte që t'i shoh edhe një herë ata vise, të shoh vendin e prindërvë të mij, që e kisha lënë me aqë mallëngjim me aqë lote ; të shoh baltën e Shqipërisë, si thotë vjershëtori³⁾, nga e cila jam krijuar.

1) «Ëndër e vërtetë» marrë nga 'Albania 1905, f. 90.

2) më hirështonte shpirtin = ma mbushte shpirtin me hir.

3) si thotë vjershëtori = e ka fjalën për Çajupin, që thotë për Shqipërinë:

Ku është balta
m'e ëmbël se mjalta.

Mendja s'më rrinte më një vend, më dukej sikur nuk mund ta bëj këtë çap të rëndë, që të largo hem nga ky vend ku ndodhem, ku u bëshë burrë, ku u rrita, ku u madhova edhe pashë të parën shkendijë dashurije; më dukej sikur gjë-kafshë më pengon, më ndalon që të mos largo-hem. Po kujtimet e vogëlisë, ata kujtime të ëmbë-la që më gëzonin kurdoherë, ata kujtime të jetës së pametë, të kthjell të, të kulluar porsi qielli i Shqipërisë në qershor, më bënин, më shtynin që t'i shoh, t'i përmend, t'i kujtoj edhe një herë.

Një mshehje e pakuptueshme më çfaqej në zemër, trupi më çelej, më gëzohej, më kënaqej kur kujtonja se do të mund të mbush këtë dëshirë të zjarrtë të zemrës sime.

Thashë me vehte: Të kapërxej male, fushë e det, të vete atje t'i shoh të gjitha: gurët, dru-rët, barërat, brigjet, kodrat, t'i ngjit e t'i zgres malet, të pi ujët e kulluar të burimeve, të kqyronj fshatrat për rredh, puntorët, bagëtitë, lulet, pemët, t'i ze me dorën time, t'i ndjenj, t'i përgë-zonj, t'i përqafonj, të nginem, të ngopem, të nxjerr mallin e zemrës.

Sa kaq u ndodhësh në kufi të Shqipërisë, në kufi të dëshirave të mia, që më rrihin zemrën ditë për ditë, orë për orë, minutë për minutë.

Ju malet e lartë me majat e mprehta,
Pyllt e dendura me vise të fshehta,
Ju burimet edhe lumenjt e kulluar,
që ujtni poshtë e lart vendin e uruar.
Ju balt' e bukur, vend i trimërisë,
Atdheu i shtrenjtë, dheu i Shqipërisë.

Ju dhe Tomori mal i shenjtëruar!
E gjithë si ç'e lashë e gjenj të pandryshuar
Me mall ika, me mall vinj përsëri
Ndjehem i lumtur edhe mund të vdes tashi !

Vura dorën në ballët, qendrova në vend, pa-shë rrrotull ; u tunda u shkunda, mos ndodhesha në ndonjë ëndër, mos ishte ndonjë çudi, mos ishte ndonjë mrekulli, që më gënjen sytë ! Tërë këto i gjykove, i mejtova, i kullova, i çkullova, po më tē vërtetë shoh se këtu ku ndodhem është dheu im, është Shqipëria ! Marr udhën e gjerë, zgres malet, marr fushën. Era më dukej e ëmbël, e shijëshme, e pëlqyer; lulet lëshonin një erë të ballsamtë⁴⁾, që tē shëron, tē çel, tē shmall ; vesa që kish rënë mbi bart shkëlqente si ca gurë tē kushtueshëm ; rrezet e diellit posa kishin dalë porsi ca shigjeta ari tē derdhura begatje, më përgëzonin, më përkëdhelnin ; mburimet duke rriedhur më ushëtinin në veshët, më gudulisnin, më dëfrenin ; rrëkeja që përhapej fushës porsi gjarpër e shkëlqente si argjend ashtu e derdhur midis gjelbërimet, më kënaqte e më merrte sytë gjer së largu ; natyra më ngrinte, më lartësonë, më dukej se fluturonja përpjetë, më dukej se ndodhesha me tē vërtetë në ëndërat që dëshëronja. Ndjehem i lumtur, i kënaqur, i gjuar. Një shfrim i dalë nga fundi i zemrës më lehtëson nga rëndësira që më rëndonte trupin aqë kohë. Sikur bëhem më i ri, sikur çelem, sikur freskohem.

4) erë tē ballsamtë = erë si tē ballsamit, lengut tē rrshirit tē pishës.

Ja Shqipëria, thashë, ja vëndi ku shkova vogjelinë që më dha jetë, që më dha dritë; ja viset që dësheronja, që isha djegur për to! Ja zogjtë që këndoijnë dhe shqiponjat si venë e vijnë me sulm, ja liqenet me viset e bukura e me ujët e kulluar! Ja bagëtitë si kullosin dhe puntorët e gëzuar si unjen e ngrihen duke punuar me djersë ja pleqtë me leshrat e gjata e të thinjura, ja trimat me pushkën më krahë si ecin udhës me kryelartësi, me robat e bardha porsi dëborë, me atë shtat të plotë, që i ngjasin Herkulit të fuqishmë, të fortë të bukur! Ja gratë punëtore dhe zemërmira, si rendin poshtë e lart, si përkujdesen për shtëpinë, çupat të turpëshme e të bukura me shtat të mermertë si t'Afroditës⁵⁾, të bardha si shkumbë e detit, symbëdha, trupholla, vetullzeza, faqekuqe si ecin me çap pëllumbi! Ja bariu i mbështetur mbi krrabët me fyellin në gojë si i bije edhe çmallet duke kënduar; dashi me këmborën që buçet gjer së largu, dhentë të urtë me shqerrat ndënë hije t'atij lisi të gjerë edhe dhitë si ngjiten nëpër shkëmbinj e drurë, që duken porsi Pani, perëndi i Dashurisë!

Ja qyteti tashti me shtëpitë e dendura e të larta, me kishët, me minaret, që duken në ethirt⁶⁾! Ja fshati im me shtëpitë e bardha me kopshte të thurura, me luadhet, me vreshtat me pemët; ja lumi, përrenjtë, brigjet, malet përtej, ja bukuria e pasosur!

Janë të gjitha me vend, si ç'i lashë, prap ashtu i shoh! Ja vendi ku losnja, ku këcenja, ku

5) Afrodita = perëndesha e bukurisë tek grekërit e vjetër.

6) ethiri = hapësira e pafund.

çfryhesha ! Të gjitha sikur më flisnin edhe unë i përkëdhelnja me sy. Sikur këndonin edhe i dëgjonja me etje, sikur qeshnin edhe unë i përgjona me dashuri !

Sa kujtime të pambaruara s'më përshkonin nëpër mendje ! Më dukej se jam prap foshnjë me ëndërat e pëlqyera, se jam i çvendosur në pamje të pa zakonshme ⁷⁾. Endjenja vehten time të lumtur se arriva atë që e mejtonja, që e dashuronja, që e ëndërronja !

Pashë diellin si një dhisk i skuqur si përendonte, si fshihej prapa malevet, majat e të cilëvet të ngjyruara edhe ato me një ngjyrë të kuqe të gjallë, porsi një vullkan që është në zjarr e flagë; pashë hënën porsi vashë bardhëllloshe me atë ëmbëlsirë të fshehtë që e ka, si ndritëte përmbi rrrethet; yjet, kandile të pashuara si xhixhillonin në qiell, era e butë si frynte e këndëshme, nata si i mbuloi e pëlqyer me fshtesinë e thellë, gjumi si i pushtonte që të gjitha !!

Po kur kështu duke u mejtar u zgjova dhe duke kqyrur përrreth i habitshëm, shoh se ndodhem gjith'atje ku isha !!

7) të pazakonëshme = të jashtzakonëshme.

III. FJALË TË RALLA QË HASEN NË KËTO

PJESE

1. bufkë-a = një lloj luleje.
2. dërmë-a = data, frikë e madhe.
3. ergjërvë-a = zhiva.
4. — fashë-a = brez leshi a pambuk që e përdornin si dizgje.
5. harbut-i = Poeti e përdor me kuptimin e vrasësit dhe të hajdutit.
6. imitoj = e gjaj, mundohem të bëj një gjë siç e ka bërë një tjetër.
7. Kasnec-i = lajmëtari, tellall (Turq.).
8. Kérthi-ni = i njomë (qengji, foshnja).
9. Kordha = këlliç pak i thyer, që pret nga një anë.
10. kut-i = një masë gjatsije më e vogël se metri.
11. kreshtë-a = maja.
12. llohë-shi = me borë a me breshër e me erë të fortë.
13. mbroth = mbarë
14. Mësalla = pëlhirë e gjatë që u vehet në prehër të ftuarve në gosti, darka, gostia.
15. mundësit = ata që dalin fitues në luftë, fitonjësit.
16. palla = shpata
17. pekule = pasuri, thesar.
18. risija = rinia, të rijt
19. shkorsë-a = qilim me lesh dhije që e shtrojnë ndër dhoma ku rrijnë.
20. shpërkënditur = shpërndarë.
21. shembëlltyrë-a = shembëll.
22. veti-ja = mirësjellja.

TRYEZA E LËNDËS

Faqe

Të dashur Pionere	5
-------------------------	---

I. VJERSHA

Të rijnje	11
Tingëllime	12
Vlesa e Atdheut	12
Betimi mi flamur (hymn patriotik)	14
Përpara (marsh kombëtar)	15
Flamuri kombëtar	17
Ardhi dita	18
Palla e Skënderbeut	21
Balashit	23
Dhëmkë	25
Në mërgim	26
Larg vatrës	28
Drinit	32
Lulëkuqeja	37
Shqipëria u lirua	39
Luftari lypës	40
Krerëve tradhtarë	43
Dua	45
Natyra	47
Trëndafili	49
Ditë prandvere	51
Prendvera	54
Perëndimi i diellit në verë	56
Qyqja	57
Pamje vjeshte	60
Vjeshta	61